

To: eazizaj <eazizaj@idmalbania.org>; Mon 2/3/2020 2:30 PM

Kthim pergjigje Nr. 157

E nderuar Zj. Azizaj!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", regjistruar me nr. 157 në regjistrin e "Kërkesave dhe Përgjigjeve", pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju informojmë si më poshtë vijon:

1. Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore deri në 31 dhjetor 2019 është **4767**.

2. Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse me status aktiv, të regjistruara në administratën tatimore për vitin 2019 (nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019) është **238**.

3. Në lidhje me numrin e përgjithshëm të organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore deri në 31 dhjetor 2019, të ndarë sipas formës (shoqatë, fondacion, qendër), ju bëjmë me dije se Administrata Tatimore nuk administron në sistem të dhëna të kësaj natyre. Forma e vetme ligjore është OJF.

4. Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore për vitin 2019 (nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019) është **238**.

5. Në lidhje me numrin e përgjithshëm të organizatave të regjistruara në administratën tatimore për vitin 2019 (nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019) të ndarë sipas formës (shoqatë, fondacion, qendër), ju bëjmë me dije se Administrata Tatimore nuk administron në sistem të dhëna të kësaj natyre. Forma e vetme ligjore është OJF.

6. Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të shpërbëra dhe në proces likuidimi në administratën tatimore për vitin 2019 (nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019) është:

- OJF që kanë kërkuar çregjistrim gjatë 2019 janë **6**,
- OJF që kanë kaluar në pasiv gjatë 2019 janë **192**.

Termi "shpërbërje dhe likuidim të OJF-ve" nuk ekziston.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit
Drejtorja e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Tel Office : 04 2276 840
Web: www.tatime.gov.al